



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"  
REKTORATI

## NJOFTIM

**PER PROCEDURAT REGJISTRIMIT NE PROGRAMET E CIKLIT  
TE PARE TE STUDIMEVE BACHELOR DHE NE PROGRAMET ME KARAKTER  
PROFESIONAL -2 VJECAR PER VITIN AKADEMIK 2018-2019 NE UNIVERSITETIN  
"EQREM ÇABEJ " GJIROKASTËR**

### Procesi i regjistrimit

1. Në datat 30 gusht deri 12 shtator 2018, të gjithë aplikantët, të cilet kanë kryer procesin e aplikimit në raundin e parë dhe janë shpallur fitues, mund të kryejnë procesin e regjistrimit me dokumentacion në sekretariatë mesimore të UGj-së në programin e studimit ku dëshirojnë të vazhdojnë studimet, **nga ora 08:00 deri ne oren 16:30**
2. Periudha 30 gusht deri 12 shtator është e ndarë në 7 faza 48 - orëshe. Secili aplikant ndjek ecurine e procesit të shpalljes fitues të tij në njerin apo disa programe studimi nga ato që ka përzgjedhur në formularin e aplikimit.
3. Kur ai është shpallur fitues, duhet të paraqitet pranë UGj-së , ku dëshiron të regjistrohet, brenda afatit 48-orësh. Nëse aplikanti nuk regjistrohet brenda afatit 48-orësh, ai humbet të drejtën e regjistrimit, në ato programe studimi ku është shpallur fitues në atë fazë. Per programet e studimit të ofruara nga për të cilat :
  - a) nuk përcaktohen kriteret shtese nga IAL-ja perkatese, me përjashtim të notës mestare ;
  - b) numri i kandidatëve është i njëjtë apo më i ulët se numri i kuotave të miratuara;

Nuk aplikohet ndarja ne faza 48 oreshe dhe kandidatet kanë të drejtën e regjistrimit gjatë gjithë periudhës së regjistrimeve të raundit të parë.

4. Procesi i regjistrimeve nga sekretarite mesimore, me dokumentacion dhe online vijon me faza 48-oreshe, ne perputhje me numrin e kuotave te parashikuara per programin perkates te studimit dhe duke respektuar renditjen ne listat e fituesve te raundit te pare.
5. Ne rast se pas çdo fazë konstatohen kuota te paplotesuara, zhvendoset vija e kuqe dhe shpallen fitues te rinj te asaj faze. Keta fitues te rinj mund te regjistrohen vetem ne fazen pasardhese. Keto faza vijojne deri ne plotesimin e kuotave dhe perfundojne ne daten 12 shtator 2018. Per programet e studimit. me kuota te paplotesuara te cilat nuk kane aplikante ne pritje, do te rikthehen ne garë aplikantet e shpallur fitues ne fazat paraardhese, te cilet nuk rezultojne te regjistruar ne programe te tjera studimi. Rikthimi ne gare kryhet sipas listes se renditjes te aplikanteve per raundin e pare.
6. Aplikantet fitues duhet te regjistrohen vetem ne nje program studimi, me perjashtim te nxenesve dhe studenteve te shkelqyer. Pas marrjes se dokumentacionit nga aplikanti dhe regjistrimit te tij, sekretaria mesimore e fakultetit ben regjistrimin online ne Portalin U-Albania. Aplikantet dorezojne personalisht ose nepermjet perfaqesuesit te autorizuar me prokure nga ana e tyre, dokumentacionin e meposhtëm:
  - Dokumentin e identifikimit (karte identiteti ose pasaporte). Në dosje mbahet vetem fotokopja;
  - Fotokopjen e noterizuar te diplomes se Matures Shteterore ose te defteses se pjekurise, se bashku me certifikaten e notave ose te nje deftese/diplome tjeter studimi te fituar jashte vendit dhe te njehësuar ne MASR;
  - Deklaraten e paraqitur ne shtojcen nr.1, bashkelidhur ketij udhezimi, e cila plotesohet nga aplikanti ne prani te punonjeses se sekretarise mesimore te IAL-se dhe te nenshkruhet nga aplikanti dhe nga punonjesja e sekretarise.
  - Mandat pagesa per tarifen e regjistrimit (2000 leke)
7. Aplikantet fitues ne nje program studimi, te cilet nuk jane regjistruar sipas afateve te raundit te pare, humbasin te drejten per t'u regjistruar. Ata kane te drejten qe te plotesojne formularin e aplikimit te raundit e dytë.

## **REKTORATI**

### **I**

## **UNIVERSITETIT “EQREM ÇABEJ” GJIROKASTËR**